PLANI VJETOR I SHKOLLËS SË MESME "TURGUT OZAL" 2026-2027

TURGUT OZAL
INSTITUCIONET ARSIMORE



Shkolla e mesme jopublike "Turgut Ozal" Durrës
Datë: 08.10.2026
Nr. Prot.: 511 - 045/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

Prot. 2472 **Durrës, më** 29 / 09 **/2026**

Lënda : Shqyrtim/miratim i dokumentacionit të Institucionit Arsimor për vitin 2026-2027

Drejtuar : Gjimnazit jopublik "Turgut Ozal"

Në respektim të Urdhërit nr.31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", ZVA Durrës konfirmon shqyrtimin e dokumentacionit të IA-së për vitin 2026-2027, respektivisht si më poshtë:

- Planin Vjetor të shkollës
- Rregulloren e shkollës
- Plani i veprimtarive jashtwshkollore

Pas shqyrtimit të tyre ZVAP shprehet si më poshtë:

Dokumentacionet e sipërcituara janë hartuar konform udhëzimeve në fuqi dhe përmbushin të gjitha parametrat për miratim nga ZVAP dhe zbatim për vitin shkollor 2026-2027.

DREJTORE

Amarilda THËRMIJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar - Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar - Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

Nr. 2122 Prot
Dt. 16.09.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENSIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
ZYRA VENDORE ARSIMORE DURRËS

SHKOLLA E MESME JOPUBLIKE "TURGUT OZAL" DURRËS

TURGUT OZAL
INSTITUCIONET
ARSIMORE

PLANI VJETOR 2026-2027

Shkolla e mesme jopublike "Turgut Ozal" Durrës

Miratoi:

Drejtor Didaktik
Elsona OKSHTUNI

Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore
Amarilda THËRMIJA

1. Hyrje

- Institucioni arsimor jopublik "Turgut Ozal" Durrës, i cili përbëhet nga Kopshti jopublik "Turgut Ozal", shkolla 9-vjeçare jopublike "Turgut Ozal" dhe shkolla e Mesme jopublike "Turgut Ozal", është pjesë e institucioneve arsimore "TURGUT OZAL" Sh.A , i cili u vu në funksionim të plotë në muajin Janar te vitit 2002 me Vendim Nr. 24 datës 28.01.2002, të **K**ëshillit të Ministrave si shkollë 8-Vjeçare. Më 6 Qershor 2005 me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 174, datës 16.06.2005 u hap dhe kopshti pranë këtij institucioni dhe me Urdhërin Nr. 235, datës 18.07.2005 u hap shkolla e mesme jopublike. .

- Ky kompleks, përbëhet nga 3 ndërtesa të veçanta që ndërlidhen me njëra tjetrën funksionalisht. Secila prej tyre disponon mjediset e mjetet e nevojshme sipas destinacionit përkatës, për të zhvilluar normalisht veprimtarinë mësimore dhe edukative me nxënësit. Në mjediset e këtyre ndërtesave kryejnë veprimtaritë mësimore edukative përkatësisht si vijon më poshtë :

  Godina 1 kopshti i fëmijëve dhe cikli i ulët (kl.1-5) i shkollës 9-vjeçare,

  Godina 2 Cikli i mesëm i ulët (kl.6-9)

  Godina **3** Cikli i Mesëm i lartë (kl. 10-12)

- Blloku i ndërtesave të kompleksit është konceptuar e realizuar sipas një projekti të parashikuar me struktura moderne, që përmbajnë të gjitha ambientet dhe mjediset e nevojshme, të plotësuara me mjete sipas kërkesave të infrastrukturës arsimore bashkëkohore. Kompleksi është funksional për të përballuar veprimtarinë mësimore edukative, me një kapacitet prej rreth 1000 nxënësish. Blloku arkitektonik ka 3 ndërtesa që lidhen me njëra tjetrën përmes korridoreve, shkallëve, ashensorëve: (ndërtesat janë 5-katëshe.Të gjitha ambientet e brëndshme e të jashtme të Kompleksit Arsimor disponojnë kushte optimale (mjedise me hapësira të nevojshme, pajisje teknologjike moderne, mjete didaktike, kabinete laboratorë, salla të ndryshme etj.), për realizimin sasior e cilësor të procesit mësimor-edukativ. E tërë infrastruktura e instaluar, është e plotësuar në mënyrë të harmonizuar në përshtatje me destinacionin përkatës. Ajo i pergjigjet mjaft mirë gjithë kërkesave për zhvillimin normal e me nivel të lartë cilësor e shkencor, të veprimtarisë mësimore edukative, që përmban kurrikula lëndore dhe programi mësimor i shkollave parauniversitare, sipas standarteve më të përparuara.

- Në mjedisin e brendshëm, ndërtesat e shkollës kanë në dispozicion një numër të konsiderueshëm ambientesh mësimore plotësuese për punë praktike konkretizuese, eksperimente praktike etj. si: auditore, klasa, laboratore, kabinete, salla kinemaje, dhoma e mjedise të veçanta për vizita e mjekim, për shërbimin psiko-social, për seanca përgatitore të veprimtarive si: olimpiada, konkurse dhe

aktivitete të ndryshme social-kulturore. Këto dhe shumë anekse të tjera, janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme sipas funksioneve të caktuara. Infrastruktura mësimore moderne i është përshtatur dhe mbështet plotësisht, realizimin e procesit mësimor - edukativ, sipas grupmoshave përkatëse duke synuar realizimin e objektivave sipas standarteve evropiane.

- Duke e vlerësuar infrastrukturën mësimore si një faktor mjaft të rëndësishëm të sistemit arsimor bashkëkohor, drejtoria e shkollës mbështet në vazhdimësi, modernizimin e mëtejshëm të procesit mësimor përmes futjes së metodave dhe elementëve të teknologjisë së lartë (tabelat elektronike, smart-board, pajisjeve dixhitale, ipad etj.). Njëkohësisht, kjo infrastrukturë ndihmon mësuesit në realizimin e programeve mësimore me nivel të lartë shkencor e pedagogjik, duke krijuar periodikisht kushte optimale për asistencë pedagogjike e metodiko-shkencore, për trajnime e kualifikime në bashkëpunim me institucionet qëndrore, me specialistë të kualifikuar nga vendi e jashtë.

2. PROCEDURA E HARTIMIT TE PLANIT

- Bazuar në Rregulloren per IAP neni 51 për Planin Vjetor të Shkollës grupi i punës i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës ka hartuar planin vjetor për vitin shkollor 2026-2027.
  Për hartimin e Planit Vjetor të Punës për vitin shkollor 2026– 2027 të shkollës së mesme "Turgut Ozal", u sigurua paraprakisht formimi i grupit qëndror të punës, si dhe nëngrupet që mblodhën dhe realizuan përpunimin e të dhënave, si dhe rezultatet e këtyre të dhënave. teknike. Referimi e krahasimi u bë në bazë të dokumentacionit zyrtar përkatës i cili paraqitet në institucionet arsimore drejtuese qëndrore.
  Gjithashtu u realizua bashkëpunimi i nevojshëm dhe partneriteti i domosdoshëm me faktorët e interesuar të poshtëshënuar:

  - Drejtoria Përgjithshme e Turgut Ozal. (DPTO).

  -Anëtarët e stafit drejtues të shkollës së mesme si dhe sektorët: sekretari, arkiv, ekipet kurrikulare.

  - Përgjegjësit e ekipeve lendore.

  - Anëtarë të bordit të shkollës, këshilli i prindërve, këshilli i mësuesve.

  - Përgjegjësit e sektorëve (financë, teknikë, transport etj)

3. ANALIZA E GJENDJES

- Pas përfundimit të vitit shkollor 2025-2026, Drejtoria e shkollës zhvilloi analizën e përgjithshme vjetore me stafin mësimdhënës, duke bërë vetëvlerësimin e cilësisë së punës, mbi bazën e arritjeve dhe plotësimit të objektivave në procesin mësimor edukativ.

  Kjo analizë u përqëndrua kryesisht në diskutimin e rezultateve konkrete të arritura në të gjithë komponentët përbërës të procesit mësimor - edukativ, krahasimit të rezultateve për secilën lëndë, të veprimtarisë studimore - shkencore, social-kulturore, të nivelit të përfaqësimit të nxënësve në konkurse, olimpiada dhe aktivitete të ndryshme, në shkallë lokale, kombëtare,etj. të krahasuara me rezultatet e vitit të kaluar.

  Paraprakisht, analizat dhe diskutimet janë zhvilluar mbi bazë klasash paralele dhe me metodën e vetëvlerësimit të punës individuale dhe asaj bashkërenduese, duke krahasuar rezultatet e arritura dhe objektivat kryesore të marra për secilën lëndë mësimore. Kjo analizë u thellua krahasimisht në raport me objektivat e përgjithshme. Bazuar në të dhënat krahasuese të treguesve kryesorë të punës mësimore edukative, të kontrollit e monitorimit gjithëvjetor nga drejtoria, inspektimi i jashtëm, anketimit me mësues, nxënës prindër, u bë evidentimi dhe arsyetimi i shkaqeve e i faktorëve për disa mangësi të vërejtura, për plotësimin e të cilëve në vitin shkollor në vazhdim, u përcaktuan detyra të veçanta me plan-veprimi për ndjekjen, zbatimin deri në realizimin e plotë të tyre.

  Në analizën vjetore të punës, krahas konkluzioneve përfundimtare, u përcaktuan detyrat dhe objektivat kryesore të punës mësimore edukative, ndryshimet e nevojshme në përmbajtje dhe infrastrukturë që do të zbatohen **për vitin e ri shkollor 2026-2027** të pasqyruara më poshtë:

A) Ndjekja e shkollës:

1. Numri i nxënësve sipas paraleleve

Nxënës Gjithsej		Klasa X		Klasa XI		Klasa XII	
GJ	**F**	**GJ**	**F**	**GJ**	**F**	**GJ**	**F**
237	**156**	**84**	**50**	**67**	**46**	**86**	**60**

2. Përqindja e mungesave kundrejt të gjitha orëve mësimore

Nr.	Treguesit	Shkolla e mesme
1.	Numri i klasave	11
2.	Numri i nxënësve	237
3.	Përqindja e mungesave (2025-2026)	1.58%

Anët e forta:

- Angazhimi i stafit drejtues dhe mësuesve në monitorimin e frekuentimit dhe zhvillimin e strategjive për përmirësimin e tij në bashkëpunim me prindërit dhe nxënësit.

- Bashkëpunimi me trekëndëshin mësues, prind, nxënës për të siguruar edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës.

<u>Anët që kanë nevojë për përmirësim</u>:
(Në përmirësim të mëtejshëm, për përsosje)

- Reduktimi i mungesave vjetore të nxënësve për të gjitha orët mësimore.

B) Aspekti social:

Aspekti social:

Nxënësit e shkollës "Turgut Ozal' Durrës përgjithësisht vijnë nga familje me arsim të lartë dhe të mesëm. Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike është minimal. Nxënësit vijnë nga qyteti i Durrësit, rrethinat e qytetit si dhe krahina të tjera të Shqipërisë. Nuk kemi nxënës të ardhur nga emigracioni. 1 nxënës vetëm me një prind.

<u>Anët e forta:</u>

- Sigurimi i mbështetjes për nxënësit nga stafi mësimdhënës si dhe zyra e orientimit dhe karrierës për të përmirësuar performancën akademike dhe udhëzimin profesional.
- Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve social-kulturore me synim garantimin e gjithëpërfshirjes së nxënësve.

<u>Anët që kanë nevojë për përmirësim</u>:

- Angazhimi në disa prej klubeve të krijuara në shkollë ishte nën nivelin e pritur

C) Arritje lëndore:

1- Nota mesatare vjetore: 9.1

2- Përqindja vjetore e kalueshmërisë: 100 %

3- Nota mesatare në provimet e Maturës Shtetërore: 9.51

4- Diferenca ndërmjet notës vjetore në të gjitha lëndët e maturës shtetërore me notat vjetore të këtyre lëndëve: 0.27

KALUESHMERIA E NXENESVE SIPAS KLASAVE X-XII VITI SHKOLLOR 2024-2025						
KLASA	**Nxënës në Qershor**		**Kalojnë në Qershor**		**100%**	**Nota mesatare**
	Gjithsej	**Femra**	**Gjithsej**	**Femra**	**KALUESHMËRIA**	
Klasa 10	84	50	84	50	100%	9.0
Klasa 11	67	46	67	46	100%	8.9
Klasa 12	86	60	86	60	100%	9.32

Diferenca ndërmjet notës mesatare të shkollës, në provimet e lëndëve të detyruara, me notën mesatare të këtyre lëndëve, në klasën e 12-të.				
Viti shkollor	**Lëndët**	**Nota mesatare në kl-12**	**Nota mesatare në provimin e MSh**	**Diferenca (vlerë absolute Nota mesatare hyrje- Nota mesatare dalje)**
	Gjuhë e huaj (Anglisht)	9.48	9.68	0.20

2025-2026	Gjuhë shqipe dhe letërsi	9.25	9.18	0.07
	Matematikë	9.11	9.66	0.55

Anët e forta:

- Arritje të larta në provimet e Maturës Shtetërore.
- Mbështetje e vazhdueshme për nxënësit nga koordinatori i cilësisë për arritjet e tyre në lëndë të ndryshme dhe olimpiada.
- Asistimi i zyrës së Këshillimit të Karrierës në motivimin e nxënësve në përzgjedhjen e profesioneve.

Anët që kanë nevojë për përmirësim:

- Ndjekja e ecurisë së punës individuale për nxënësit që kanë nevojë për përmirësim në lëndë të caktuara, me fokus në identifikimin e vështirësive specifike, ofrimin e mbështetjes së personalizuar dhe monitorimin e vazhdueshëm të rezultateve për të siguruar përparim të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave mësimore.

D) Etika dhe sjellja

Nxënësit e shkollës sonë kanë zbatuar Rregulloren e Brendshme të shkollës dhe kanë patur marrëdhënie të mira, të rregullta, miqësore dhe korrekte me njëri-tjetrin. Kanë respektuar mësuesit, shokët e shoqet, kanë ruajtur mjedisin dhe nuk kanë dëmtuar orenditë e shkollës. Gjithashtu, gjatë mësimit, në pushim, vërejmë vetëkontroll e sjellje të mira të nxënësve. Veshja e tyre ka qënë sipas sipas kodit të veshjes të rregullores së shkollës. Gjatë vitit shkollor komisioni i etikës dhe sjelljes ka marrë në shqyrtim të gjitha rastet që janë paraqitur. Nxënësit kanë zbatuar rregulloren për sa i përket veshjes së uniformës në shkollë. Gjatë vitit shkollor janë referuar 3 ankesa në Komisionin e Etikës dhe Sjelljes.

Anët e forta:

- Ofrohet një shërbim psiko-social dhe mjekësor cilësor.
- Nxënësit tanë dallohen për sjellje korrekte, si brenda shkollës ashtu edhe jashtë saj.

- ❖ Nxënësit respektojnë me përpikmëri rregulloren e shkollës dhe kultivojnë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin dhe stafin pedagogjik.
- ❖ Nxënësit tregojnë përkushtim dhe përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave të tyre si nxënës dhe si qytetarë të ndërgjegjshëm.
- ❖ Ka një bashkëpunim të frytshëm ndërmjet mësuesve kujdestarë dhe prindërve.

<u>Anët që kanë nevojë për përmirësim:</u>

- ❖ Në raste të veçanta, vërehet përdorimi i shprehjeve jo të përshtatshme në mjedisin e klasës e të shkollës.

E) Mësuesi

1. Numri i mësuesve gjithsej: 19
2. Mësuesit kanë përvojë të pasur në mësimdhënie.
3. Mësuesit kujdestarë dhe ata të lëndëve kanë mbajtur kontakte të rregullta me prindërit dhe kujdestarët ligjorë, duke siguruar vijimësi të qëndrueshme në arsimimin e nxënësve.
4. Në fillim të vitit shkollor dhe gjatë tij, stafi pedagogjik mori pjesë në trajnime dhe seminare të ndryshme, ku u pajisën me certifikata, si me kredite ashtu edhe pa kredite.
5. Janë zhvilluar trajnime të specializuara nga ekspertë vendas dhe të huaj, të cilët kanë një përvojë të thelluar në fushën e mësimdhënies.

<u>Anët e forta</u>:

- ❖ Falë bashkëpunimeve tona me organizatorë të ndryshëm, stafi pedagogjik i shkollës sonë ka mundësinë të marrë pjesë në një sërë konferencash dhe seminare mbi arsimin dhe edukimin.
- ❖ Niveli i lartë i mësimdhënies, paraqitja e rregullt dhe në kohë e mësuesve, marrëdhëniet e drejta me drejtuesit, nxënësit dhe prindërit, si dhe përgjegjshmëria e lartë për detyrat dhe shembulli pozitiv në punë dhe sjellje për nxënësit, kontribuojnë në forcimin e anëve të forta të shkollës tonë në këtë aspekt.

- Mësuesit shkëmbejnë përvojat e tyre, diskutojnë sfidat dhe arritjet, dhe zbatojnë me korrektësi detyrat e caktuara nga drejtoria. Ata zbatojnë në mënyrë të përpikshme kurrikulën e re të bazuar në kompetenca dhe përdorin metoda dhe teknika bashkëkohore në mësimdhënie. Po ashtu, mësuesit janë përdorues të aftë të teknologjisë në procesin mësimor.

<u>Anët që kanë nevojë për përmirësim</u>:

- Mësues me ngarkesë mësimore në dy cikle shkollore.

F) Pjesëmarrje në projekte me fondacione, Olimpiada, konkurse dhe gara të ndryshme

Shkolla organizon dhe mbështet nxënësit për pjesëmarrjen në konkurse dhe olimpiada të ndryshme në nivel shkolle, ZVA-je, kombëtare dhe ndërkombëtare.

1- Konkursi i Artit dhe Letërsisë,
Organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Kolegjeve "Turgut Ozal", një konkurs që mbledh bashkë të gjithë talentet si në krijimtari, pikturë, këngë dhe intepretim.
Në këtë konkurs nxënësit tanë fituan: 6 medalje bronzi, 7 medalje argjendi

2- Konkursi Shkencor dhe Shoqëror "ASEF",
Organizuar nga Drejtoria e përgjithshme e kolegjeve "Turgut Ozal" sjell projekte dhe ide
të shumta ku nxënësit prezantojnë denjësisht arritjet e tyre, duke u ballafaquar me vlerësimin nga juri profesioniste.
Në këtë konkurs nxënësit tanë fituan në këto kategori:
Asef Shoqëror: 18 pjesëmarrje, medalje bronzi, 14 argjendi dhe 11 ari
Asef shkencor: 5 pjesëmarrje, 21 medalje bronzi, 13 argjendi dhe 9 ari.

3. Konkursi COGITO MATH

20 pjesëmarrës

Medalje të fituara: bronzë 9, argjend 6, ari 3

4. FLL (First Lego League)

20 nxënës pjesëmarrës, 3 grupe
3 grupet madalje SILVER,

5.Pjesëmarrje në Olimpiada Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Punë sistematike, hap pas hapi për të arritur rezultate sa më të larta në garën shkencore e shoqërore duke përfaqësuar shkollën dhe arritur suksese të vazhdueshme, ky është qëllimi kryesor që nxënësit promovojnë ndër vite.

OLIMPIADA KOMBËTARE FAZA 2

Kaluan fazën e dytë 40 nxënës në lëndët :

- ✓ 7 nxënës në Biologji
- ✓ 2 nxënës në Kimi
- ✓ 2 nxënës në Matematikë
- ✓ 9 nxënës në Informatikë
- ✓ 3 nxënës në Gjeografi
- ✓ 8 nxënës në Letërsi
- ✓ 2 nxënës në Fizikë
- ✓ 7 nxënës në Histori

OLIMPIADA KOMBËTARE FAZA 3

Arritjet e nxënësve në fazën e tretë

1 Nxënës rezultuan fitues në vendin e tretë,të dytë dhe të parë të Olimpiadave të zhvilluara nga MAS konkretisht :

- ✓ 1 nxënës çmim të parë BORIS BRAHO, Informatikë
- ✓ 1 nxënës çmim të dytë PRAJLA TABAKU, Histori,

OLIMPIADA NDËRKOMBËTARE

- Medalje bronzi në konkursin INFOMATRIX
- Medalje nderi në IMO 2025 (Australi)
- *4 medalje të artë,1 medalje të argjendë dhe 1 vlerësim "Highly Commended ". Olimpiada Britanike e Biologjisë (British Biology Olympiad)*
- *medalje nderi, në edicionin e 14-të Kupës Europiane të Matematikës EMC 2025*
- Çmim nderi EGMO 2026 (Gjeorgji)
- *1 Medalje Nderi në Olimpiadën e Tretë Botërore të Inteligjencës Artificiale (Kazakishtan 2026)*

G) Infrastruktura

1- Gjendja e godinës shkollore është shume e mirë, ka ujë të mjaftueshëm, ndërtesa ka ajër, dritë të mjaftueshme dhe ngrohje të mirë.
2- Shkolla disponon oborr me hapësira të gjera ku ndodhen dy ambiente sportive.
3- Klasat e mësimit, korridorët, kabinetet dhe mjediset e brendshme kanë përmasat dhe hapësirat e duhura sipas standarteve.
4- Raporti nxënës-mësues për vitin shkollor 2025-2026 ishte në shifrat 12 me 1.
5- Gjendja e pajisjeve shkollore është shumë e mirë. Baza materiale, bankat, dërrasat, tavolinat, raftet, kompjuterat, printerat, aparaturat dhe orenditë e tjera janë të reja, të përshtatshme dhe komode për mësim.
6- Kemi në gjendje shumë të mirë 4 laboratorë mësimorë me pajisjet e duhura: të fizikës, të kimisë, të biologjisë, të informatikës, një bibliotekë, 2 palestra të mbyllura, ambiente të hapura sportive, 1 sallë për klubin e Robotikës, dy salla të multimedias me monitor, 11 klasa me televizor Smart dhe 1 sallë kinemaje. Në laboratorin e informatikës çdo nxënës ka kompjuterin e vet ku gjithashtu kemi instaluar dhe sistemin e internetit.
7- Shkolla zotëron edhe mjete të mjaftueshme didaktike-mësimore në gjendje shumë të mirë për të gjitha lëndët, veçanërisht për gjuhët e huaja (anglisht, turqisht dhe gjermanisht).
8- Shkolla disponon bibliotekë e cila u jep mundësinë nxënësve të ulen e të lexojnë brenda ambientit ose të tërheqin libra dhe ti lexojnë .
9- Ndërtesa e shkollës ka numër të mjaftueshëm të tualeteve me ujë të rrjedhshëm dhe të pastra përherë për dy gjinitë, si për nxënës/ nxënëse ashtu dhe për personel të shkollës;
10- Gjithashtu hapësirat si korridore , oborri i shkollës janë të mjaftueshme për kalimin e kohës së lirë nga nxënësit sipas standarteve
11- Me mjetet që posedojmë, sigurojmë kushte optimale për mësim në të gjitha lëndët.

<u>Anët e forta</u>:

- Shkolla disponon 11 klasa të pajisura me televizorë smart.
- Shkolla ofron laboratore dhe mjete didaktike bashkëkohore për zhvillimin e lëndëve shkencore (fizikë, biologji, kimikë) dhe sociale.
- Ka ambiente të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe organizimin e klubeve të ndryshme.

<u>Anët që kanë nevojë për përmirësim</u>:

- Hasen vështirësi në organizimin e sjelljes dhe marrjes së nxënësve nga shkolla për shkak të rrugës së amortizuar, e cila ndikon në krijimin e trafikut të dendur.

H) Komuniteti

Për një mbarëvajtje sa më të mirë të proçesit mësimor i kushtohet një rëndësi e veçantë partneritetit shkollë -familje. Mësuesit kujdestarë mbajnë kontakte të shpeshta me prindërit e nxënësve për ti informuar ata,
Zhvillohen gjatë vitit disa takime me prindër me qëllim që prindërit të vihen sa më shpesh në dijeni në lidhje me ecurinë mësimore si dhe sjelljen e fëmijës në shkollë.
Prindërit njoftohen për çdo aktivitet apo veprimtari tjetër që zhvillon shkolla.

I) Qëndrimi i klientit:

Sipas kontakteve të vazhdueshme të drejtpërdrejta, mendimeve të shprehura gojarisht dhe përgjigjeve të dhëna pyetësorëve që ka bërë shkolla, nxënësit tanë dhe prindërit e tyre janë përgjithësisht të kënaqur me cilësinë e shërbimit që u ofron shkolla, me kushtet e favorshme për mësim, disiplinën, rregullin dhe organizimin e punës në shkollë, me përkushtimin, afërsinë dhe kujdesin e mësuesve dhe drejtuesve të saj.

4. **Synimet e shkollës**

A. Zhvillimi i potencialit të nxënësve dhe arritje sa më të suksesshme në olimpiadat kombëtare dhe ndërkombëtare.

B. Integrimi i teknologjisë iPad në zhvillimin e procesit mësimor për klasat X–XII dhe shfrytëzimi i platformave digjitale në mësimdhënie.

A. Zhvillimi i potencialit të nxënësve dhe arritje sa më të suksesshme në olimpiadat kombëtare dhe ndërkombëtare.

- **Objektivat**:

✓ Të sigurohet pjesëmarrja dhe motivohet angazhimi i nxënësve në të gjitha fazat e olimpiadave, në nivel shkolle, rajonal dhe kombëtar, përmes mbështetjes së vazhdueshme të tyre.

✓ Të rritet numri i medaljeve argjendit dhe arit të fituara në konkursin shkencor " ASEF " Albanian Science Engineering Fair" nga 22 vitin e kaluar në 24.

- **Veprimtari**

- Ngritja e grupit të punës që do të merret me monitorimin e veprimtarive të shkollës për arritjen e objektivit, të përbërë nga mësues, prindër dhe drejtoria.
- Prezantimi i olimpiadave dhe konkurseve te nxënësit aktual dhe nxënësit e rinj.
- Evidentimin e nxënësve pjesëmarrës në aktivitetet e përmendura më sipër.
- Përgatitja e planit vjetor nga grupet e punës me olimpiadat.
- Ftesa e ish-fituesve të olimpiadave për të ndarë përvojat dhe motivuar nxënësit.
- Zhvillimi i testimeve provë para zhvillimit të olimpiadave
- Evidentimi dhe orientimi i nxënësve sipas tematikës dhe ideve krijuese për projektet e ASEF shoqëror dhe shkencor.
- Organizimi i orëve mësimore shtesë.
- Përdorimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie nga ana e mësuesve.
- Ekspozitë me punët e punuara nga nxënësit në ambientet e shkollës.
- Dhënia asistencë nga ana e shkollës për kryerjen e regjistrimeve online
- Raportimi dhe analizë e punës në drejtorinë e shkollës në lidhje me ecurinë e zhvillimit të olimpiadave, konkursit të Asef .
- Ngritja e grupit të punës që do të merret me monitorimin e veprimtarive të shkollës për arritjen e objektivit, të përbërë nga mësues, prindër dhe drejtoria.

PLANI I VEPRIMTARIVE

NR	OBJEKTIVAT	VEPRIMTARIA	AFATI	PËRGJEGJËSIT
1	Të sigurohet pjesëmarrja dhe motivohet angazhimi i nxënësve në të gjitha fazat e olimpiadave, në nivel shkolle, rajonal dhe kombëtar, përmes mbështetjes së vazhdueshme të tyre	Prezantimi i olimpiadave te nxënësit	Shtator 2026	- Mësuesit e lëndëve përkatëse në bashkëpunim me nëndrejtorët dhe kordinatorët mësimorë
		-Evidentimin e nxënësve pjesëmarrës në aktivitetet e sipër përmendura.	Shtator 2026- Tetor 2026	- Mësuesit e lëndëve përkatëse
		-Përgatitja e planit vjetor nga grupet e punës me olimpiadat.	Gusht 2026	- Ekipet lëndore
		Organizimi i orëve mësimore shtesë.	Përgjatë vitit shkollor	Drejtoria e shkollës në bashkëpunim kordinatorin e cilësisë dhe mësuesit
		-Raportimi i punës në drejtorinë e shkollës në lidhje me ecurinë e olimpiadave.	Çdo muaj i vazhdueshëm	- Drejtoria në bashkëpunim me mësuesit

	Të rritet numri i medaljeve argjendit dhe arit të tuara në konkursin shkencor " ASEF " Albanian nce Engineering Fair" nga 22 vitin e kaluar në 24.	Orientimi i nxënësve në realizimin e projekteve duke përdorur teknologjinë dhe burimet online si mjet mbështetës për zhvillimin, hulumtimin dhe prezantimin efektiv të projekteve shkencore.	- Tetor 2026- Janar 2027	-ekipet kurrikulare Mësuesit lëndor
		Organizimi i prezantimit të projekteve brenda shkollës dhe më pas midis shkollave	Nëntor 2026- shkurt 2027	-Drejtoria e shkollës Ekipet lëndore Mesues lëndor
		Ceremonia e ndarjes së cmimeve të projekteve fituese	Nëntor 2026- shkurt 2027	Drejtoria e shkollës Ekipet lëndore Mesues lëndor

		Ekspozitë me punët e punuara nga nxënësit në ambientet e shkollës. **Pasqyrimi i arritjeve të nxënësve.**	**-Janar 2027-Maj 2027**	**-Drejoria-Ekipet kurrikulare-Administrata e shkollës**

B. Integrimi i teknologjisë iPad në zhvillimin e procesit mësimor për klasat X–XII dhe shfrytëzimi i platformave digjitale në mësimdhënie.

- **Objektivat**:

✓ Të pajisen dhe integrohen në mënyrë të qëndrueshme përdorimi i iPad-ëve te nxënësit e klasës së 10.11-të në funksion të procesit mësimor dhe aparaturave moderne digjitale.

✓ Të rritet nota mesatare në lëndën gjuhë angleze për klasat e 10-ta nga 9.3 vitin e kaluar në 9.36.

- **Veprimtari**

- Ngritja e grupit të punës që do të merret me verifikimin e gjendjes
- Pajisja nxënësve të klasave 10. 11 me iPad
- Pajisja e mësueve që japin mësim në klasën 10. 11-të me iPad.
- Rinovimi i pajisjeve digjitale në klasat multimedia dhe përshtatja e materialeve didaktike të cilat mund të përdoren në mënyrë efektive iPad dhe televizorët interaktivë.
- Trajnimi i mësuesve me trajnues vendas dhe të huaj për metodat ndërvepruese të mësimdhënie si dhe organizimi i trajnimeve për mësuesit mbi përdorimin e iPad dhe aparaturave moderne digjitale gjatë procesit mësimor.
- Vëzhgim në orë mësimorë për matjen e arritjes së objektivit.

Klasa 10. 11-të, orë mësimore praktike, ku nxënësit përdorin iPad për kërkime, prezantime ose aplikime mësimore si dhe zbatimi i aktivitete mësimore, përdorimi i aplikacioneve edukative si Kahoot, Quizlet, Google Classroom, Notability etj. Mbledhja e feedback nga nxënësit dhe mësuesit.

- Monitorimi i vazhdueshëm i përdorimit të iPad dhe pajisjeve digjitale në funksion të procesit mësimor nga zyra e IT.
- Analizimi i rezultateve të nxënësve në fillim të vitit dhe evidentimi i fushave ku paraqiten vështirësi nga nxënësit.

- Vlerësime të rregullta të progresit dhe mbështetje shtesë për nxënësit sipas nevojave.

- Organizimi i orëve mësimore shtesë dhe hartimi i një orari të posaçëm.

- Ekspozitë e projekteve kulturore në gjuhën Angleze.
- Përdorimi i një platformë online(kahoot) për të organizuar një kuiz të ndërveprueshëm në gjuhën angleze . Nxënësit mund të marrin pjesë përmes iPad.
- Raportimi dhe analizë e punës në drejtorinë e shkollës në lidhje me ecurinë.

PLANI I VEPRIMTARIVE

NR	OBJEKTIVAT	VEPRIMTARIA	AFATI	PËRGJEGJËSIT
1	Të pajisen dhe integrohen në mënyrë të qëndrueshme përdorimi i iPad-ëve te nxënësit e asës së 10.11-të në funksion të procesit mësimor dhe aparaturave moderne digjitale.	Ngritja e grupit të punës që do të merret me verifikimin e gjendjes	Qershor-Gusht 2026	Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me zyrën IT
		Pajisja e nxënësve klasa 10.11 me iPad. Pajisja emësueve që japin mësim në klasën 10. 11-të me iPad	Shtator 2026	IT në bashkëpunim me sektorin e teknikës
		Rinovimi i pajisjeve digjitale në klasat multimedia dhe përshtatja e materialeve didaktike të cilat mund të përdoren në mënyrë efektive iPad dhe televizorët interaktivë.	Shtator 2026	IT në bashkëpunim me sektorin e teknikës

		Monitorimi i vazhdueshëm i përdorimit të iPad dhe pajisjeve digjitale në funksion të procesit mësimor nga zyra e IT.	Gjatë gjithë vitit	Mësuesi i Lëndës Zyra IT
2.	Të rritet nota mesatare në lëndën gjuhë angleze për klasat e 10-ta nga 9.3 vitin e kaluar në 9.36	Analizimi i rezultateve të nxënësve në fillim të vitit dhe evidentimi i fushave ku paraqiten vështirësi nga nxënësit.	Shtator 2026-Nëntor 2026	Koordinatori i cilësisë Mësuesi i Lëndës
		Vlerësime të rregullta të progresit. Mbështetje shtesë për nxënësit.	Nëntor 2026- Maj 2027 Gjatë gjithë vitit	Drejtoria Koordinatori i cilësisë Ekipi Lëndor Mësuesi i Lëndës

		Ekspozitë e projekteve kulturore në gjuhën angleze.	Muaji i Gjuheve te Huaja, Java e Gjuhes angleze	Ekipi Lëndor Mësuesi i Lëndës
		Përdorimi i një platformë online (kahoot) për të organizuar një kuiz interaktiv në gjuhën angleze. Nxënësit mund të marrin pjesë përmes iPad	Muaji i Gjuheve te Huaja, Java e Gjuhes Angleze	Ekipi Lëndor Mësuesi i Lëndës

5. VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Nr.	Veprimtaria	Afati	Përgjegjësi

1.	Organizim dhe monitorim për zhvillimin e mbledhjeve/takimeve mësues-prind-nxënës	Shtator 2026, Qershor 2027	Drejtoria e shkollës
2.	Evidentim i nxënësve që hasin vështirësi në lëndë të ndryshme. Analizë e problemit.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Mësuesi lëndor
3.	Organizimi mësimeve shtesë dhe monitorimi mbi pjesëmarrjen dhe funksionimin e këtyre orëve suplementare.	Gjatë vitit	Drejtoria e shkollës Mësuesit lëndorë
4.	Realizim i orëve suplementare sipas një plani të detajuar për të përfshirë të gjithë lëndët dhe të gjithë nxënësit për Maturën Shtetërore 2027	Gjatë gjithë vitit shkollor	Mësuesit lëndor Sipas planifikimit të drejtorisë
5.	Analizë e rezultateve të testeve provë të maturës shtetërore 2027 dhe informim i prindërve mbi rezultatet	Shkurt 2027, Maj 2027	Drejtoria e shkollës Mësuesit e lëndëve Mësuesit kujdestarë
6.	Prezantimi i Rregullores së shkollës	Shtator 2026	Mësuesit kujdestarë
7.	Ndjekje ditore e frekuentimit dhe problemeve që mund të paraqesin nxënësit.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Mësuesit kujdestar Drejtoria e shkollës
8.	Realizim i testeve të kontrollit.	Në fund të tremujorëve	Drejtoria e shkollës,

9.	Komunikim i vazhdueshëm me prindërit në grup ose individualisht për informim të problemeve që paraqiten dhe për përcjellje të informacionit të nevojshëm.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Drejtoria e shkollës Mësuesi kujdestar
10.	Analizë e arritjeve lëndore për çdo tremujor dhe evidentimi i pikave që kanë nevojë për përmirësim.	Cdo fund tremujori	Drejtoria e shkollës, Mësuesit kujdestarë, Mësuesit e lëndëve, Grupi statistikës
11.	Organizimi i takimeve të ndryshme me prindër, profesionistë, psikolog etj. ku zhvillohen diskutime, seminare, ide dhe sugjerime.	Çdo muaj	Drejtoria e shkollës Zyra e këshillimit dhe orinetimit Zyra e shërbimit psiko-social
12.	Monitorimi i muajve të lëndëve	Çdo muaj	Drejtoria e shkollës Ekipet lëndore Koordinatori i Cilësisë
13.	Organizimi dhe monitorimi i i konkursit të Artit dhe Letërsisë	Tetor 2026- Nëntor 2026	Mesuesit e gjuhë letërsisë Koordinatori i Cilësisë Drejtoria e shkollës
14.	Gjithëpërfshirja masive e nxënësve në projekte, veprimtari plotësuese.	Gjatë vitit	Mësuesi ndihmës i qeverisë së nxënësve, psikologu

15.	Caktimi i grupit të punës për zhvillimin e klubeve shkollore me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e aftësive dhe talenteve të nxënësve.	Shtator 2026 – Tetor 2026	Drejtoria e shkollës Zyra e këshillimit dhe orientimit Mësuesit
16.	Organizimi dhe monitorimi i klubeve shkollore	Tetor 2026 - Maj 2027	Drejtoria e shkollës Zyra e këshillimit dhe orientimit
17.	Takime dhe diskutime individuale dhe në grup me të gjithë nxënësit në zyrën e këshillimit të karrierës, me qëllim nxitjen e nxënësve drejt arritjeve të rezultateve më të larta dhe zgjedhjeve të duhura për studimet e mëtejshme.	Tetor 2026 - Maj 2027	Zyra e këshillimit dhe orientimit
18.	Organizimi i konkurseve lëndore	Tetor 2026 - Maj 2027	Drejtoria e shkollës Ekipet Lëndore
19.	Aktivitete edukative, shkencore, artistike, kulturore, sportive gjatë vitit.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Drejtoria e shkollës Mësuesit përgjegjës
20.	Takim me bordin e shkollës dhe qeverinë e nxënësve për të diskutuar ide, mendime dhe sugjerime lidhje me shkollën, mbarëvajtjen e procesit mësimor, si dhe veprimtaritë ekstrakurrikulare	Tetor 2026	Drejtoria e shkollës Bordi I shkollës Qeveria e nxënësve

21.	Zhvillimi i orëve të hapura dhe Peer Observation me qëllim zhvillimin profesional të mësuesve	Shtator 2026-Maj 2027	Mësuesit Koordinatori i Cilësisë Drejtoria e shkollës
22.	Analizë vjetore	Gusht 2027	Drejtoria

SYNIMET DHE VEPRIMTARIA KUALIFIKUESE

Për të realizuar me cilësi objektivat që ka shkolla drejtoria e shkollës në bashkëpunim me ekipet lëndore dhe koordinatorët akademikë janë hatuar plane të veçanta për zhvillimin profesional të stafit pedagogjik. Këto veprime do t'i përgjigjen nevojave profesionale që kanë mësuesit aktualisht në shërbim të realizimit në tërësi të planit të punës së shkollës. Trajnimet do të realizohen me Drejtuesit e Ekipeve Lëndore, Lektorë nga shkolla e drejtorëve.

Programi i kualifikimit të brendshëm të stafit do të bazohet në organizimin në grupe mësuesish të rinj dhe ata me përvojë në bazë ekipesh lëndore sipas planeve vjetore të hartuara paraprakisht. Do të realizohen peer observation, orë të hapura, trajnime javore për mësuesit e rinj. Sipas një programi të miratuar nga Drejtoria e shkollës, përgjegjësit e ekipe lëndoreve në bashkëpunim me kordinatorët akademikë zhvillojnë sipas specialiteteve, mbledhje analitike, seminare trajnimi, informacione shkencore, trajnime metodike sipas planit të zhvillimit professional të brendshëm, hartuar në fillim të vitit shkollor, duke iu përgjigjur kërkesave të mësuesve, në funksion të përmirësimit të performancës dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie.

Krahas këtyre trajnimeve me grupe mësuesish, pasi janë mbledhur pyetësorët dhe anketimet për tematikat dhe trajnimet, Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të kolegjeve planifikon të organizojë me grupe te vecanta seminare, me lektorë të jashtëm, të specializuar në fushën e pedagogjisë e psikologjisë, shkencave të ndryshme, etj.

7. VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS

Vlerësimi i brendshëm i shkollës do të zhvillohet duke iu referuar *urdhrit nr.268, datë 28.08.2020 për "Miratimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës"*.

Vlerësimi i brendshëm do të përfshijë të gjithë punonjësit arsimorë të shkollës, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretar in si dhe të gjithë organizmat e shkollës. Ai do të mbulojë të gjitha fushat e cilësisë si vijon *Drejtimi dhe menaxhimi* ; *Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit; Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve dhe Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve*. Këto fusha të cilësisë do të jenë në përputhje me udhëzuesin "Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës", ASCAP, 2020;

Do të caktohet grupi qëndror, i cili përbëhet nga administrator i shkollës, nëndrejtorët e shkollës, kryetarët e ekipeve lëndore, koordinatorët akademikë, përgjegjës të teknikës, përgjegjës të administratës, psikologia, doktoresha e shkollës.
- kryhet në nivel individual (drejtori, nëndrejtori, mësuesi) dhe në nivel organizmash të shkollës (drejtoria, këshilli i mësuesve, ekipi lëndor).
Vlerësimi i brendshëm do të shtrihet përgjatë vitit shkollor sipas një planifikimi të posatshëm.

Për të ndjekur në vazhdimësi realizimin cilësor të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit, stafi drejtues i shkollës në bashkëpunim me ekipet lëndore dhe koordinatorët akademikë, gjatë këtij viti shkollor, do të zhvillojë orë vëzhgimi me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së mësimdhënies dhe reflektimin e tyre në rezultatet e të nxënit.

Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet monitorimit të mbarëvajtjes së procesit mësimor sipas fushave përkatëse.

Gjithashtu, në vëzhgimet që do të zhvillohen gjatë vitit, është parashikuar të monitorohen edhe aspekte të tjera të veprimtarisë së shkollës siç janë ato për realizimin e objektivave të planeve edukative, në zhvillimin dhe efikasitetin e veprimtarive social kulturore.

Plani i kontrollit do të përfshijë: planifikimin mësimor (planet vjetore, ditari, modelet dhe formatet, metodikat dhe mjetet bashkëkohore që përdorin mësuesit gjatë mësimdhënies. Regjistri online SMIP, amza dhe dokumentacioni bazë që përmban "**Dosja e Mësuesit" etj**.

Për të arritur një efektivitet sa më të lartë në punën drejtuese e organizuese, stafi i drejtorisë së shkollës, do të monitorojë vazhdimisht zbatimin e detyrave në mbarëvajtjen e punës së përditshme në sektorë të ndryshëm (shërbimi mjeksor, psikologjik, higjiena, ushqimi, menca, transporti, IT, teknika, etj).
Duke filluar nga nisja e përgatitjeve për vitin e ri shkollor e deri në përfundim të tij.

8. VEPRIMTARITË EDUKATIVE DHE EKSTRAKURRIKULARE

Për realizimin e të gjitha veprimtarive të paraqitura në Planin Vjetor, drejtoria e shkollës, do të sigurojë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Turgut Ozal, ZVA-Durrës , organet kolegjiale të shkollës, ekipet lëndore, mësuesit kujdestarë, si dhe faktorë të tjerë të jashtëm të interesuar.

Për realizimin sa më cilësor të veprimtarive edukative dhe trajnim+kualifikimit të mësuesve, është hartuar një **Plan-Kalendari Akademik** i veçantë për vitin shkollor 2026-2027, i miratuar edhe nga Drejtoria e shkollës "Turgut Ozal".

Kalendari Akademik do të zbatohet në përshtatje me synimet, kërkesat e prindërve, nxënësve dhe kushtet e shkollës së mesme "Turgut Ozal".

Veprimtaritë edukative, social-kulturore, artistike e sportive, do të zhvillohen mbi bazë **klasash paralele** brenda shkollës dhe jashtë saj në rang shkolle brenda e jashtë vendit. Ndërsa grupet e përzgjedhura (funksionojnë mbi bazë klubesh të caktuara) në përfaqësimin e shkollave të mesme në rang qyteti, do të përgatiten e trajnohen nga mësues specialistë të lëndëve përkatëse. Këto grupe nxënësish do të marrin pjesë në veprimtaritë midis shkollave të Tiranës, si dhe në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, në fushën e shkencave, artit, kulturës, sportit dhe veprimtarive të tjera. Mbi bazën e anketimeve të organizuara nga shkolla me nxënësit sipas dëshirave të shprehura përcaktohen dhe një numër aktivitetesh të ndryshme.

9. LEGJISLACIONI

a) Ligji Nr. 69/2012 (i ndryshuar), datë 21.06.2012 « Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë» i ndryshuar;

- Kodi i Etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat – Miratuar nga MAS- 30 nëntor 2013.
- Urdhri nr 31 datë 28.01.2020 «Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë»
- Udhëzuesi Nr.17, datë 22.07.2024 «Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve »
- Udhëzimi Nr.17, datë5.7.2022, " Për vlerësimin e nxënesve në sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar me udhëzimin nr. 11, datë 26.06.2023, Për një shtesë në Udhëzimin nr 17, datë5.7.2022, " Për vlerësimine nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar".
- Udhëzimi Nr.25, datë 2.8.2013 (i ndryshuar) «Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve »
- Udhëzimi Nr.26, datë 2.8.2013 «Për përcaktimin e detyrave dhe funksionëve të këshillit të mësuesve»

- Udhëzimi Nr.25, datë 25.07.2018 (shtesa) «Për ngritjen e bordit të institucionit arsimor »
- Udhëzimi Nr.30, datë 2.8.2013 «Për rregulloren tip të instuticionëve arsimore »
- · Udhëzimi Nr.44, datë 21.08.2013 (shtesa)«Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit»
- · Urdhri Nr. 313, datë 20.10.2020 (shtesa)«Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social »
- Urdhër 600 datë 19.10.2023 për miratimin e '' Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve ne arsimin e mesëm të ulët" (klasat 6-9)
- Udhëzim nr.14, dt. 10.07.2023 për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e Arsimit Parauniversitar
- Urdhri i Përbashkët për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2026-2027 në sistemin arsimor parauniversitar (Miratimi i Strukturës së Vitit Shkollor 2026-2027 në Sistemin Arsimor Urdhër Nr.110, datë 21.04.2026.)
- Udhëzim i Përbashkët Nr. 15 Datë 18.08.2026 Për Vitin Shkollor 2026-2027 Në sistemin Arsimor Parauniversitar.

Kryetar i bordit të shkollës **Drejtor Didaktik**

Adnan QUKU **Elsona OKSHTUNI**

Kryetar i bordit të shkollës

Adnan QUKU

Drejtor Didaktik

Elsona OKSHTUNI